



Хемија - Албански

EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI KIMI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 220202510072

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
☐ Novi Sadi ☒ Beogradi ☐ Nishi ☐ Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
☒ 2 + 3 ☐ 1 + 2 ☒ 4 + 1 ☐ 2 + 4 ☐ 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
KIMI

1. Cila prej substancave është substancë e thjeshtë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ acidi klorhidrik ☐ oksidi (IV) i karbonit
☐ hidroksidi i natrijunit ☐ magnezi

2. Cila njësi përdoret për masën?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ grammi ☐ litri ☐ metri ☐ gradë celzius

3. Cila pjesë e aparaturës duhet për metodën e kullimit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ hinka ☐ kapësja e drurit ☐ masha ☐ gypi i gomës

4. Përse enët për zierjen e ushqimit nuk përdoren nga plumbi?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ është helm. ☐ ka veti magnetike.
☐ ka dendësi të vogël. ☐ nuk e përcjell nxehtësinë.

5. Cila substancë do ta ndryshojë ngjyrën e kuqe të letrës së lakmuesit në të kaltër?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ kripa e kuzhinës ☐ hidroksidi i magnezit
☐ acidi klorhidrik ☐ oksidi (IV)-i sulfurit

6. Ngjyros rrethin para fjalisë e cila përshkruan sjelljen e drejtë sipas rregullave në laborator.

☐ Kemikaliet që janë të ndieshme në dritë ruhen në enë të errëta.
☐ Aroma e lëngut përcaktohet me nuhatje direkt nga ena.
☐ Dorezat mbrojtëse duhet të hiqen patjetër para kryerjes së eksperimentit.
☐ Teprica e kemikalieve kthehet në ambalazhën origjinale.





7. Cilit grup të substancave i përket substanca me formulë kimike CH_3COOH ?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ oksideve ☐ acideve karboksile
☐ aldehideve ☐ alkooleve
8. Nafta është lënda e parë që përdoret për përfitimin e energjisë elektrike, masave plastike, vënien në lëvizje të automjeteve etj. Cilat komponime e përbëjnë naftën?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ esteret ☐ alkoolet ☐ hidrokarburet ☐ acidet karboksile
9. Gjergji dëshiron të rrisë masën muskulore të tij. Përveç trajnimit të rregullt, trajneri i ka sugjeruar që të marrë ushqime proteinike. Cilin ushqim duhet ta konsumojë më shumë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ patate ☐ ullinjë ☐ vezë ☐ bukë
10. Cili pohim është i saktë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Substancat me lidhje kimike kanë pikë të ulët të vlimit.
☐ Substancat me lidhje jonike në temperaturë dhome janë lëngje.
☐ Substancat me lidhje kovalente jopolare janë të tretshme në ujë.
☐ Substancat me lidhje kovalente jopolare janë të patretshme në ujë.
11. Si quhen komponimet me formulë molekulare të njëjtë kurse me formulë strukturale të ndryshme?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ izotope ☐ izomerë ☐ izolatorë ☐ indikatorë
12. Sa gram substancë X duhet të shtojmë në 50 g ujë që të fitohet tretje e ngopur në temperaturë dhome? Tretëshmëria e substancës X në temperaturë dhome është 36 g.
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ 72 g ☐ 18 g ☐ 9 g ☐ 36 g






13. Vaidi ka marrë detyrë të analizojë nëse oksidi i panjohur në reaksion me ujin jep acidin. Çka i nevojitet? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ peshorja
- ☐ indikator
- ☐ makina
- ☐ trup i ngrohtë

14. Cila substancë mungon në ekuacionin e reaksionit kimik?



Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Zn(OH)_2 ☐ ZnO ☐ Zn ☐ ZnS

15. Ngjyros rrethin në fushën përkatëse që të lidhësh substancat me rolin e tyre në reaksionin e djegjes së etinës.

	Reaktanti	Produkti i reaksionit
CO_2	☐	☐
C_2H_2	☐	☐
H_2O	☐	☐
O_2	☐	☐

16. Cila substancë e kryen transportin e oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në procesin e frymëmarrjes? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ heksanoli
- ☐ glicina
- ☐ glukoza
- ☐ hemoglobina





17. Cili është pohimi i saktë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Kationi ka më shumë protone se elektrone.
- ☐ Secili atom ka numër të njëjtë të protoneve dhe të neutroneve.
- ☐ Anioni ka më shumë neutrone se protone.
- ☐ Secila molekulë ka numër të njëjtë të protoneve dhe të neutroneve.
18. Cila substancë fitohet kur metali reagon me oksigjenin?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ uji
- ☐ oksigjeni
- ☐ hidrogjeni
- ☐ oksidi i karbonit(IV)
19. Cilit tip të reaksioneve i përket reaksioni i shtuarjes së klorit në eten, ku fitohet 1,2-diklor etani?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ adrimi
- ☐ oksidimi
- ☐ elektroni
- ☐ zëvendësimi
20. Ngjyros rrethin në fushën përkatëse që të lidhësh secilën substancë me produktin e saj të hidrolizës.

Substanca	acidi karboksilik	monohidroksidi	aminoacidi
vaji i lulediellit	☐	☐	☐
proteina	☐	☐	☐
polisaharidi	☐	☐	☐
disaharidi	☐	☐	☐



FAQE E ZBRAZËT



Хемија - Албански



ИНТЕРНО

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
KIMI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT									

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

